



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Fëmijëve



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701281/4

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave për disa përmirësime në funksion të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shkollën Speciale Luigj Gurakuqi, Tiranë.*

Drejtuar: **Drejtorisë Arsimore Rajonale e qytetit**
Drejtoreshës, Zj.Arjola Byzyka

TIRANË

Për dijeni: **Z.Elmas Lala**
Drejtor i Shkollës Speciale "Luigj Gurakuqi"

TIRANË

E nderuar Zj.Drejtoreshë,

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të njerëzore të fëmijëve dhe në rastin konkret të fëmijëve me aftësi ndryshe, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, kanë kryer një inspektim në Shkollën Speciale "Luigj Gurakuqi" në Tiranë.

Në këtë institucion trajtohen fëmijë të qarkut Tiranë, të moshës nga 6 deri në 19 vjeç. Dhe në përmblyllje të ciklit të detyrueshëm shkollor, pra të klasës së 9-të kryhet dhe testimi i programit të 9 vjeçares për këta nxënës.

Programi i kësaj shkolle është i veçantë, i miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Fëmijët regjistrohen mbi bazën e një raporti mjeko-ligjor dhe përgjithësisht kanë diagnozat-Autizëm, Sindroma down, Prapambetje mendore. Ky proces kryhet mbi bazën e përcaktimeve të Dispozitave Normative për Arsimin Parauniversitar. Vetë shkolla ka një komision multidisiplinar që e fillon punën që në muajin Maj. Por formalizimi dhe përmblyllja e regjistrimeve kryhet nga komisioni multidisiplinar i DAR Tiranë.

Këtë vit shkollor 2017-2018 janë të regjistruar 125 nxënës në këtë Shkollë Speciale.

Lidhur me kapacitetin e kësaj shkolle, praktikisht vlerësohet mbi kapacitet, pasi raporti i duhur është 1 mësues për 8 nxënës, ndërkohë që aktualisht në Shkollën Speciale "Luigj Gurakuqi" ky raport qëndron 1 mësues me 10 nxënës.

Po ashtu duhet vënë në dukje dhe patur parasysh se kemi të bëjmë me një institucion arsimor, dhe jo me një qendër sociale.

Pjesa më e madhe e mësuesve punojnë mbi bazën e planeve individuale për fëmijët, të cilat hartohen në bashkëpunim dhe me prindërit.

Shkolla e ka Rregulloren e brendshme të funksionimit të saj, ku përcaktohet se “jep shërbim në fushën e arsimimit, edukimit, mirërritjes dhe kulturës shëndetësore për nxënës me aftësi të kufizuara mendore”.

Fondi (buxheti) vjetor që është afro 10 milion lekë i kalojnë këtij Institucioni nga Bashkia e Tiranës. Transporti, ushqimi dhe librat e fëmijëve, të cilat janë falas për ta, janë zëra që përcillen nga Bashkia e Tiranës, ndërsa fondet për stafin ndihmës, personelin pedagogjik nga DAR Tiranë.

-Struktura (për stafin pedagogjik) miratohet nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës, ndërsa struktura mbështetëse (stafi administrativ) miratohet nga Bashkia Tiranë

Për këtë vit shkollor 2017-2018 personeli i institucionit përbëhet nga 36 veta, nga të cilët 24 janë personeli pedagogjik; një logopedist; drejtori; nëndrejtori dhe një psikolog. 7 nga mësuesit janë të diplomuar për pedagogji speciale, ndërsa 4 mësues kanë master në psikologji.

-Infermierja megjithëse nuk është e përfshirë në organikë, është shtuar si pjesë e stafit nga ana e Autoritetit Shëndetësor Rajonal.

Në çdo kat të godinës ka pajisje kundra zjarrit. Godina e institucionit është e re, e rikonstruktuar nga Bashkia në Prill 2017 (rikonstruksioni i periudhës Qershor 2016-Prill 2017), ndaj kushtet e saj janë optimale.

Godina është e pajisur me sistem kamerash, në korridore si dhe në kuzhinë. Pulti i sistemit të kamerave mbahej nga drejtori, por nuk ishin të elaboruar mënyrën e ruajtjes së imazheve (ruhen veç 1 muaj).

Drejtuesit e kishin në qendër të vëmendjes vendosjen e kutisë së ankesave dhe në momentin e inspektimit na relatuan që ishte çështje ditësh vendosja e saj.

Mund të themi që afishimet e të drejtave e detyrimeve, rregullorja dhe akte të tjera, me poste ilustruese, etj ishin model mjaft i mirë i informimit me të drejtat e detyrimet e nxënësve dhe stafit të kësaj shkolle.

Institucioni ishte inspektuar së fundmi nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë.

Në kuadrin e rastit të publikuar në një media (në Tetor 2017) dhe nga morëm iniciativën që ta inspektonim këtë institucion, siç dhe na u relatua nga stafi drejtues, 4 mësuese ishin pezulluar nga puna nga ana e Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë. Drejtori dhe këto punonjëse ishin marrë në pyetje në Komisarjatin e Policisë nr.4 Tiranë, dhe në inspektimin e fundit drejtori kishte marrë dijeni që materialet i ishin dërguar Prokurorisë së rrethit Tiranë. Ndërkohë që Drejtoria Rajonale Arsimore e Tiranës kishte sjellë 3 mësues zëvendësues (të specializuar në pedagogji speciale). Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve që mbulon këtë shkollë ishte NJMF e Njesisë Administrative nr.3 Tiranë.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

(-) Mungesa e një **mjeku neurolog ose neuropsikiatër**, konsiderohej mjaft problematike. Ndaj i ishin bërë disa herë kërkesa Ministrisë së Shëndetësisë.

(-) Nuk ka **punonjës socialë** në organikë, dhe për këtë ishte kryer korrespondencë me DAR Tiranë.

(-) Si shkollë speciale që konsiderohet, nuk kishte **rampë** për fëmijë me aftësi të kufizuara lëvizëse (megjithëse nuk kishin të tillë të regjistruar).

(-) Shumica e fëmijëve (50%) janë fëmijë me autizëm dhe madje ka dhe fëmijë me prapambetje të thellë mendore, ndaj nga shumë mësuese që takuam konsiderohej një problem puna me ta (Ndërkohë që shkolla funksionon dhe është ngritur për fëmijët me prapambetje të lehtë mendore). Problem që na u relatua ishte dhuna ose sjelljet agresive të nxënësve ndaj mësuesve. Problematikë përbënin një numër i konsiderueshëm fëmijësh me sjellje agresive, që shpesh përbëjnë rrezik për shëndetin e të tjerëve apo dhe të mësuesve.

(-) Institucioni kishte vetëm një **logopedist**, ndërkohë që mbi 60 apo 70 janë autikë. Pra duhen shtuar mësues me këtë specialitet.

Sa më lart, në mbrojtje dhe në respektim të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri, të përpjekjeve për realizimin e një procesi arsimimi cilësor për çdo fëmijë pavarësisht aftësive të tij/saj si dhe drejt gjithëpërfshirjes, si dhe nisur nga fakti se për rastin e publikuar nga mediat ishin ndërmarrë hapat e nevojshëm të shqyrtimit dhe ndjekjes nga instancat përkatëse, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për:

1-Shtimin e organikës së Shkollës Speciale “Luigj Gurakuqi” me disa pozicione pune (**mjeku neurolog ose neuropsikiatër, logopedist, punonjës socialë**), si dhe vijimin e trajnimeve për stafin e ri të Qendrës .

2-Po ashtu konsiderimi i nevojës për **shtimin e mësuesve ndihmës** për arsye të diagnozave dhe nevojës për shërbime suplementare që këta fëmijë paraqesin.

3-Marrjen e masave për realizimin e parimeve të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara bazuar në nenin 63 të Ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Vijimin e punës për trajnimin e vazhdueshëm të stafit për të siguruar arsimin cilësor si dhe për shkëmbime përvojash për mësuesit e shkollave të zakonshme që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

I bindur në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj, në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të punës me këta fëmijë me aftësi ndryshe,

Me respekt

K O M I S I O N E R I

ERMIR KAPEDANI